

**Raporti i vlerësimit të cilësisë nga studentët
për vitin akademik 2022/2023
Programi: Menaxhimi dhe Inovacioni në Turizëm**

1. Hyrja

Në këtë raport janë paraqitur vlerësimet e programit, të stafit akademik dhe lëndëve nga studentët e programit: Menaxhimi dhe Inovacioni në Turizëm.

Vlerësimi i programit është realizuar përmes pyetësorit për vlerësim të programit, të vendosur në Sistemin e Menaxhimit Universitar (SMU), i cili përmbanë 21 komponente. Ky vlerësim realizohet një herë brenda një viti akademik dhe vlerësimi bëhet nga studentët e këtij programi. Pyetjet e vlerësimit të programit janë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likertit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3- Pajtohem pjesërisht; 4 - Pajtohem; dhe 5 - Pajtohem plotësisht).

Vlerësimi i stafit akademik dhe lëndëve është realizuar, gjithashtu, përmes pyetësorit të vendosur në Sistemin e Menaxhimit Universitar (SMU). Për dallim nga vlerësimi i programit, i cili realizohet një herë brenda vitit akademik, vlerësimi i stafit akademik realizohet në çdo semestër. Pyetjet, edhe të ky vlerësim, janë të ndërtuara në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likertit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3 - Pajtohem pjesërisht; 4 - Pajtohem; dhe 5 - Pajtohem plotësisht).

**1.1 Raporti i vlerësimit të Programit nga studentët për vitin akademik
2022/2023**

Bazuar në rezultatet e vlerësimit të programit, të paraqitura në tabelën nr.1, vërejmë se shumica e komponenteve të këtij sesioni janë vlerësuar pozitivisht nga studentët. Vlen të theksohet se, bazuar në rezultatet e këtij vlerësimi, të gjitha komponentet janë të vlerësuara mbi 3.5. Duke iu referuar rezultateve, menaxhmenti i këtij Fakulteti, duhet t'i kushtojë rëndësi të gjitha

komponenteve, të cilat janë vlerësuar nën 4. Marrë në përgjithësi kënaqshmërinë e studentëve me programin, këtë vit akademik është 78 % ose 3.9.

Tabela nr.1 Vlerësimi i programit

Pyetja	Mesatare
Materialet e prezantuara gjatë ligjëratave ju ofrohen studentëve rregullisht	4.02
Literatura e sugjeruar për lëndët na bëhet e ditur që në fillim të semestrit	4.14
Syllabuset e lëndëve ofrohen me kohë studentëve	4.12
Studentët janë të njoftuar me orarin e konsultimeve të mësimdhënësve	4.06
Orari i konsultimeve me mësimdhënësit respektohet	3.86
Që në fillim të vitit studentët janë të njoftuar me mënyrën e vlerësimit për lëndën përkatëse	4.16
Metodat e mësimdhënies ofrojnë mënyrën më të mirë të arritjes së rezultateve të mësimnxënies	3.92
Mësimi online (përmes Microsoft Teams) nuk dallon shume nga ai në klasë	3.59
Sistemi i Menaxhimit Universitar (SMU) është i lehtë për përdorim dhe i plotëson nevojat e studentëve	3.86
Sallat e mësimi janë të pajisura mirë me mjete audio-vizuele për mësim cilësorë	3.80
Ekziston një lidhje e mirë e mësimi teorik dhe atij praktik	3.71
Studenti është i lirë që vet të përcaktohet për lëndët zgjedhore	4.00
Orari i mësimi shpallet me kohë	4.02
Orari i shpallur i mësimi respektohet nga mësimdhënësit	4.06
Programi i studimit është në përputhje me nevojat e tregut të punës	3.80
Programi i studimit është i krahasueshëm me programet e ngjashme në Universitete të tjera	3.82
Angazhimi i studentit në lëndë është e balancuar (nuk është e mbingarkuar)	3.96
Puna praktike jashtë institucionit organizohet mirë nga universiteti	3.53
Mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve janë të njohura për studentët	3.51
Mendimi im i përgjithshëm për këtë program të studimit është pozitiv	3.86
Këtë program të studimit do t'ia sugjeroja edhe të tjerëve	3.73

1.1 Raporti i komulativ i vlerësimit të stafit akademik për programin MSc. Menaxhimi dhe Inovacioni në Turizëm për vitin akademik 2022/2023

Stafi akademik i programit Menaxhimi dhe Inovacioni në Turizëm është vlerësuar në çdo semestër nga studentët dhe janë paraqitur rezultatet komulative të vlerësimit për secilin komponent në tabelën nr.2. Bazuar në rezultatet e vlerësimit të stafit akademik, vërejmë se të gjitha komponentet e këtij sesioni janë vlerësuar pozitivisht nga studentët, ose më saktësisht mbi 4. Nga rezultatet e paraqitura në tabelë, vërejmë se më së paku është vlerësuar përdorimi i platformës Teams në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Vlen të theksohet se, edhe pse mësimi është mbajtur me prezencë fizike, platforma Teams është përdorur mjaft shumë nga stafi, si për dërgimin e materialeve, detyrave kontrolluese, etj. Gjithashtu, menaxhmenti i këtij Fakulteti, duhet të mbetet i përkushtuar që të përmirësojë edhe më tutje kënaqshmërinë e studentëve me stafin akademik. Marrë në përgjithësi, kënaqshmëria e studentëve me stafin akademik për vitin 2022/2023, është 91.4% ose 4.57.

Tabela nr.2 Vlerësimi i stafit akademik

Pyetjet	Mesatarja
Mësimdhënësi organizon dhe prezanton mirë materialin e lëndës	4.63
Mësimdhënësi përdor shembuj të mjaftueshëm praktik në klasë (raste studimore, punë praktike në laborator)	4.53
Mësimdhënësi i ka kushtuar kohë të mjaftueshme sqarimit të koncepteve komplekse	4.59
Mësimdhënësi jep udhëzime të qarta dhe të mjaftueshme për të kuptuar ushtrimet dhe detyrat e lëndës	4.65
Njohuritë dhe përvojat praktike të mësimdhënësit në industri kanë qenë të dobishme për mua	4.52
Gjatë orëve të ligjëratave mësimdhënësi u ka dhënë mundësi studentëve të bashkëveprojnë mes tyre	4.50
Mësimdhënësi ka nxitur pjesëmarrjen aktive dhe debatin mes studentëve	4.44
Mësimdhënësi ka qenë i çashtë për sqarime dhe ndihmë shtesë me lëndën	4.65
Mësimdhënësi më ka dhënë informata kthyesë të dobishme dhe konstruktive për detyrat/angazhimet tjera	4.57
Mësimdhënësi ka nxitur interesimin tim për lëndën dhe fushën në përgjithësi	4.56
Mësimdhënësi ka përdorur mirë teknologjinë gjatë procesit mësimor (teams, forms, programe softuerike etj...)	4.66

Në tabelën numër 3 janë shfaqur rezultatet e vlerësimit të lëndëve nga studentët në programin Menaxhimi dhe Inovacioni në Turizëm, ku të gjitha komponentet e këtij sesioni janë vlerësuar mbi 4 dhe kënaqshmëria e studentëve në lëndët e programit është 4.19 ose 83.8%.

Tabela nr.3 Vlerësimi lëndëve

Pyetjet	Mesatarja
Lënda është e përshtatshme për programin e studimit	4.62
Qëllimi dhe objektivat e lëndës janë të sqaruar mire	4.60
Literaturat dhe materialet shtesë të lëndës (librat, shembujt praktik, burimet shtesë për lexim) ishin të përditësuara, të çashtme, dhe të përshtatshme	4.39
Lënda është realizuar në mënyrë efektive (bazuar në syllabusin e lëndës)	4.59
E kam pasur të qartë se çfarë pritet prej meje sa i përket angazhimeve të mia në këtë lëndë	4.54
Mjetet dhe materialet e përdorura gjatë mësimit më kanë ndihmuar të kuptoj lëndën më mir	4.45
Aktivitetet në klasë më kanë ndihmuar të kuptoj lëndën më mir	4.27
Lënda ka pasur një balancë të mirë të ligjëratave teorike dhe mësimit praktikës (ushtrimeve numerike, rasteve të studimit, vizita studimore etj..)	4.19
Kam pasur informata të detajuara për mënyrën e vlerësimit	4.51
Puna në grupe më ka ndihmuar të zhvilloj shkathtësitë e bashkëpunimit	4.07
Mësimi praktik (puna në laborator, puna në terren, përdorimi i shembujve praktik etj....) më ka ndihmuar të zhvilloj kompetencat profesionale	3.96